



NJOFTIM PËR SHTYP

## Prezantohet studimi i ri rajonal i UN Women – një hap përpara drejt kuptimit të dinamikës komplekse të dhunës ndaj grave përmes teknologjisë

5 dhjetor 2023

Dyzet e një për qind e grave shqiptare aktive në internet kanë përjetuar gjatë jetës së tyre një nga format e dhunës përmes teknologjisë – thotë studimi i ri "[Ana e errët e digjitalizimit: dhuna ndaj grave përmes teknologjisë në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore](#)". Shqipëria ishte pjesë e këtij studimi njëvjeçar që ka shqyrtuar format dhe përhapjen e dhunës ndaj grave përmes teknologjisë dhe ndikimin e saj në qëndrimet, përvojat dhe aksesin e grave dhe vajzave në shërbime.

Objekt i kësaj dhune kanë qenë mesatarisht 53,2% e grave nga të gjitha vendet që morën pjesë në këtë studim (ku përfshihen Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Gjeorgjia, Kazakistani, Kosova<sup>1</sup>, Kirgistani, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Taxhikistani, Turqia dhe Ukraina. Më se një e treta e grave që përjetojnë dhunë përmes teknologjisë përballen me të në platformat e mediave sociale si Facebook dhe Instagram. Në Shqipëri dhe Turqi Instagrami u identifikua si media sociale ku ushtrohet më së shumti kjo lloj dhune.

Sipas studimit, pjesa më e madhe e dhunës ndaj grave përmes teknologjisë kryhet nga persona të panjohur (50,3%), ndërsa në 32,1% të rasteve ajo ushtrohet nga persona të afërt me gratë, si partnerë, familjarë, miq, të njohur, eprorë ose kolegë, çka përbën vazhdim të mëtejshëm të dhunës që ushtrohet *offline*. Të anketuarat në Shqipëri raportuan se autorët kryesorë të kësaj dhune janë partneri aktual ose ish-partneri (pasuar nga një anëtar i familjes dhe eprori).

Studimi u prezantua online në praninë e 100 përfaqësuesve nga organizata të shoqërisë civile, mekanizmat kombëtarë për barazi gjinore, institucione të të drejtave të njeriut, partnerë zhvillimi, kompani teknologjike, institucione të arsimit të lartë, dhe ekspertë nga fusha të ndryshme. Aktiviteti u organizua nga Zyra Rajonale e UN Women për Evropën dhe Azinë Qendrore në bashkëpunim me Koalicionet për Veprim të Brezit të Barazisë në fushat tematike të dhunës me bazë gjinore dhe të teknologjisë dhe novacionit.

---

<sup>1</sup> Referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekst të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

Gülden Türköz-Cosslett, Drejtoresha Rajonale në detyrë e UN Women për Evropën dhe Azinë Qendrore, theksoi rolin e dyfishtë të teknologjisë si mundësuese e fuqizimit dhe, për fat të keq, si një mjet për të ushtruar më shumë dhunë me bazë gjinore. “Në peizazhin gjithnjë në evoluim të shekullit të 21-të, digjitalizimi vazhdon të formësojë botën tonë. Ky studim, i kryer në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, na ndihmon të kuptojmë më mirë dhunën ndaj grave përmes teknologjisë. Dhuna përmes teknologjisë, në të gjitha format e saj, ushtrohet për të njëjtat arsye: për të mbajtur nën kontroll dhe marginalizuar gratë, si dhe për të kufizuar lirinë e tyre”, vuri në dukje ajo.

Drejtuesja e studimit, Marija Babovic, prezantoi gjetjet kryesore të tij, të cilat u bazuan në anketimet e kryera me mbi 12 000 gra në të gjithë rajonin dhe në intervistat me përfaqësuese dhe përfaqësues të organeve qeveritare dhe të shoqërisë civile. Një konkluzion i rëndësishëm ishte se ndonëse teknologjia dhe digjitalizimi ofrojnë mjete të fuqishme për fuqizimin e grave, ato gjithashtu u ofrojnë dhunuesve mjete për të kryer dhe shtuar dhunën ndaj grave. “Përparimet e shpejta në teknologji dhe keqpërdorimi i saj zhvillohen shumë më shpejt se aftësitë e aktorëve shtetërorë dhe të shoqërisë civile për t’iu kundërpërgjigjur në mënyrë efektive dhunës ndaj grave,” theksoi Marija Babovic.

Në aktivitet u trajtuan edhe aspekte si investimi për parandalimin dhe reagimi ndaj dhunës përmes teknologjisë. Aty u diskutua gjithashtu edhe situata ekzistuese normative dhe institucionale, si dhe rolet dhe këndvështrimet e aktorëve të angazhuar në këtë fushë për ofrimin e shërbimeve parandaluese dhe mbështetëse për të mbijetuarat e dhunës së ushtruar përmes teknologjisë. Në aktivitetin prezantues mori pjesë edhe Robert Gajda, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ai përshëndeti realizimin e këtij studimi, duke vënë në dukje mungesën e studimeve, analizave dhe monitorimeve të mirëfillta për këtë çështje në Shqipëri. “Ky studim na ndihmon të advokojmë për politika dhe strategji, duke bashkuar perspektivat kombëtare dhe ndërkombëtare. Në Shqipëri ndeshemi me sfida për shkak të moskuptimit dhe të mungesës së kapaciteteve për ta trajtuar këtë problem”, tha Robert Gajda.